

UNOSEK/PR/14
E premte, 8 shtator 2006

Beogradi dhe Prishtina vazhdojnë diskutimet në Vjenë për decentralizimin, trashëgiminë kulturore dhe për të drejtat e komuniteteve

Vjenë – Më datën 7 dhe 8 shtator në Vjenë, delegacioni i Beogradit dhe ai i Prishtinës vazhduan diskutimet për decentralizimin, trashëgiminë kulturore dhe për të drejtat e komuniteteve, në kuadër të bisedimeve të drejtpërdrejta që po mbahen nën udhëheqjen e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për statusin e ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisari. Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm, Albert Rohan, e kryesoi takimin.

“Diskutimet ishin shumë konstruktive dhe të përqendruara në temë lidhur me të tria çështjet”, z. Rohan u tha mediave në fund të bisedimeve dyditore. Megjithatë, ai shtoi, se: “Nuk është arritur përparim i madh dhe nuk mund të flasim për arritje të mëdha përkundër atmosferës së mirë dhe konstruktive të bisedimeve”.

Gjatë raundit të shtatë të bisedimeve për decentralizim, z. Rohan, shprehu mirënjohjen e tij duke thënë se “pala e Kosovës i ka bërë disa lëshime para takimit. Fatkeqësisht, e njëjta nuk vlen edhe për palën tjetër. I kemi diskutuar gjerë e gjatë pikat kryesore kontestuese, siç janë kompetencat në shëndetësi, në arsimin e lartë, në polici e drejtësi lokale dhe në marrëdhëniet mes komunave serbe të Kosovës dhe institucioneve të Serbisë. Janë arritur përparime të vogla, por nuk është bërë hap i madh përpara.” Të dyja palët u pajtuan të takohen më 15 shtator për të diskutuar vetëm çështjen e komunave të reja.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm i përshkroi diskutimet për trashëgiminë kulturore dhe fetare si “të mira dhe të përqendruara në çështjen e zonave mbrojtëse”. Ai shtoi se të dyja palët u pajtuan për nevojën e themelimit të një instrumenti zbatues dhe monitorues, i cili do të mbikëqyrë zbatimin dhe rregullimet në teren. Z. Rohan tha se kisha ortodokse serbe e dorëzoi një listë të dëshirave në fushën e privilegjeve tatimore dhe të doganimit, cila do të jetë si shtesë e privilegjeve që gëzohen nga të gjitha besimet fetare të Kosovës. Kjo listë do të shqyrtohet nga Prishtina, e cila, përkujtoi zëvendësi i të dërguarit të posaçëm, është pajtuar në parim që t’i përmbushë këto kërkesa specifike. z. Rohan gjithashtu tha se Beogradi e siguroi UNOSEK-un që pas marrëveshjes rreth zonave mbrojtëse, ata do të jenë të gatshëm t’i kthejnë artifaktet arkeologjike të zhvendosura nga Prishtina në vitet 1998-1999.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm tha se të dyja delegacionet për herë të parë diskutuan pikë për pikë aspektet më të rëndësishme të mbrojtjes së komuniteteve në bazë të propozimit gjithëpërfshirës të Prishtinës. “Ne pamë se ka dallime mjaft të mëdha në aspektin konceptual dhe operacional mes palëve, tha z. Rohan. “Këtu kemi shumë punë për të bërë”, ai shtoi, duke cituar “pikat siç janë: përfaqësimi i komuniteteve në kuvendet komunale, në gjykata, në Qeveri, çështjet e përdorimit të gjuhës dhe mekanizmi për “interesat vitale”, të cilat duhet t’u parandalojnë mbivotimin e komuniteteve që gjenden në pozitën e pakicës nga shumica.” Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm kërkoi nga delegacioni i Beogradit që t’i dorëzojnë me shkrim pikëpamjet e tyre lidhur me këtë çështje.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm tha se UNOSEK-u do të vazhdojë punën rreth këtyre çështjeve praktike “përderisa ekziston mundësia e përparimeve”. Ai shtoi se z. Ahtisaari dhe UNOSEK-u do të punojnë rreth këtyre çështjeve në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Kontaktit, nga i cili kanë marrë përkrahjen dhe besimin e plotë.